

SKËNDER SAKAJ

DIELLI ËSHTË I TË GJITHËVE, HËNA ËSHTË E IMJA

ROMAN BIOGRAFIK

BOTIMET TOENA

SKËNDER SAKAJ

DIELLI ËSHTË I TË GJITHËVE,
HËNA ËSHTË E IMJA

roman

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2018

Ky libër u botua me mbështetjen e Bashkisë së Tiranës.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktorë: Kujtim Dashi *dhe* Besa Vila

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike *dhe* kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-24-4

©Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

“Librat janë për ata njerëz
që urojnë të ishin diku tjetër.”

MARK TUEN

PJESA E PARË

Historia e një ëndrre

“Lahu dhe vishu shpejt, dorëzo ç’ke për të dorëzuar, takohu me të gjithë dhe sa më shpejt t’i bësh këto punë, aq më mirë do të jetë për ne!”, - kaq më kish thënë Nikolla dhe priste i shqetësuar duke lëvizur brenda atij sheshit të madh të shpimit. Ai gjithmonë lëvizte kur priste për dikë apo për diçka.

Nikolla kishte një lloj të ecuri të veçantë që kush e shihte atë për herë të parë, me siguri do ta quante nazeli për mos thënë mendjemadh, por në fakt nuk ishte ashtu. Nikolla qe njeri i mirë, i thjeshtë, punëtor, njeri human dhe dashamirës, dhe krejt i ndryshëm nga të tjerët, vetëm për punën bëje fjalë me atë njeri, i cili asnjëherë nuk e kishte mendjen te dënimet. Nuk u vonova shumë, tërë ato punë i bëra shpejt, gati me një frymë. Ikëm. Ishte dita e fundit e javës, ditë e diel, ditë krejt e zakonshme për të gjithë ata që punonin në naftë.

Qe tamam ai moment kur ne ndjemë diçka, si zhurma e një guri i hedhur në lumë dhe bëri që shoferi ta ndalte makinën në vend. Shpejt ai doli nga pas saj, ndërsa vetë u shkëputa nga tërë ato mendime tepër të hallakatura që më kishin mbajtur si pengun e tyre përgjatë gjithë atij rrugëtimi të gjatë dhe të lodhshëm. Asgjë të qartë nuk kisha në mendje deri në atë kohë. Nuk po e kuptoja fare se çfarë po ndodhte në të vërtetë me mua.

- Skënder, - foli vetëm njëherë Nikolla dhe e tha pikërisht në atë kohë kur shoferi e kish nisur sërish makinën. - Si fillim, djalë, po të them se po të çoj në një detyrë të vështirë, - foli qetë-qetë Nikolla. - Kjo që do të them tani është një vendim i marrë nga unë, është urdhër i pakthyeshem, por më parë desha të thosha që ti të më dëgjosh me kujdes, madje mos u mërzit, se do të flas gjatë dhe, kur të vijë koha, edhe unë do të dëgjoj ty po me të njëjtin kujdes dhe respekt.

Fjalët e Nikollës më tingëlluan si në formën e një urdhri të qartë dhe të prerë. Nuk më mbetej gjë tjetër veçse ta dëgjoja drejtorin tim dhe njëherësh të kujdesesha që, me një vëmendje sa më të kthjellët e të përqendruar, të arrija të kuptoja sa më mirë, saktë dhe shpejtë se çfarë po ndodhte në të vërtetë me mua; isha vërtet në dilemë. Makina ecte. Ndërkohë Nikolla sapo kish nisur që ta shpaloste tërë qëllimin e tij që kish pasur për mua, dhe pse e kish organizuar atë takim.

Nikolla ishte me origjinë minoritare. Disa fjalë të thëna nga ai ishin “pa pikë e presje”, siç thuhej me

shaka, të po atij dialekti, të minoritarit. Edhe pse ai kish ikur fare i vogël nga fshati i tij rrëzë kufirit; dhe pse ai kish bërë tërë atë shkollë për inxhinier gjeolog nafte, sërish ai kuptohej se i përkiste asaj treve. Sepse dhe emrin tim ai e shqiptonte po në dialektin e minoritarit, Skëndere. Nikolla ishte njeri aq i mirë, sa njeriu mund ta mendojë se në këtë botë ka vërtet njerëz të atillë që zor se ia gjen çiftin.

E gjithë ajo bisedë midis nesh, Nikollës dhe meje, së fundi nisi të bëhej pa praninë e shoferit, nën dritën e qartë të asaj hëne, e cila kish kohë që kish dalë, dhe dukej se ecte si me përtim drejt kupës të qiellit, që asokohe ajo qe larguar dukshëm nga majat e maleve më të larta. Pikërisht ajo lloj hëne dukej se po vetëtregohej aq e kujdesshme në të ecurën e saj, tamam si një kllloçkë e re, që shkel ashtu lehtësisht dhe tërë delikatesë mbi vezët e shtruara nën barkun e saj. Dhe herë-herë ajo lloj hëne dukej se e hidhte vështrimin nga shumohen yje të pambuluara anës barkut të saj, si vetë kllloçka që vështron vezët e pambuluara përreth saj.

Siç e thashë, Nikolla qe njeri i mirë, në tërësinë e tij, si njeri dhe si një drejtues aq i përveçëm dhe merakli për çdo gjë.

- Djema, - thoshte ai sa herë nëpër ato takimet e zgjeruara kur bëheshin me punonjësit, - bëni të mira në këtë botë dhe kush nuk i ka ato mundësitë për ta bërë atë të mirë, le të rrijë i qetë në punën e tij dhe mos të prishi punë se ashtu duhet. Dhe atë të mirë që

e bëni as mos e kujtoni dhe as mos e kërkonti, bëjeni të mirën dhe hidheni në det, dhe kurrë mos shikoni më prapa me mendimin, se ç'është ju keni bërë. Se kjo botë është tamam si deti i madh që një ditë t'ju nxjerr të gjitha përjashta, me të mirat dhe të ligat si dhe vetë deti.

Nikolla kish folur deri atëherë si një mekanizëm i kurdisur dhe rrallëherë kish parë nga unë.

- Ajo që do të them tani, djallë, është më e rëndësishme si për ty, por në veçanti për mua. - Hapa sytë tërë habi dhe prisja surprizën e radhës nga ai njeri, ndërkohë që mendoja se tërë jetën time kisha njohur shumë pak njerëz si Nikolla. - Tani më dëgjo me kujdes, - tha me vendosmëri dhe vazhdoi të fliste. - Që nesër ti do të jesh përballë me inxhinierin e shpimit të këtij pusi, një ters njeri dhe, për të gjitha këto që do të them tani të lutem më dëgjo me tërë kujdesin tënd, se është shumë delikat ky problem që do të them tani. Ai inxhinier, për ne si ndërmarrje, na është bërë i padurueshëm. Si ai tersi i Pojanit që e tregojnë. Por mos e harro se ai është inxhinier dhe nuk është aspak budalla nga natyra. Është vërtetë aq i zgjuar, si i thonë asaj fjalës në popull, gjarpër, dhe di të lëndojë m'u atje ku njeriut i dhemb më shumë, ai flet troç dhe nuk ta mban fare anën po i shkele në kallo, por ama thonë se kush ia gjen anën, për çudi, për atë njeri ai tregohet se është vërtetë njeri i mirë. Thonë se ka dhe mendime shumë të vyera dhe përparimtare.

Nikolla përfundimisht më kish emëruar përgjegjës in e puseve për naftë dhe gaz. Ishte një gëzim i madh për mua. Kurrë nuk e kisha menduar një gjë e tillë deri në atë kohë se do të më vinte një ditë aq e afërt dhe do të m'i sillte tërë ato të mira njëherësh, tamam ashtu, si të rëna nga qielli.

Një rrogë bazë maksimale për atë detyrë, pa e filluar fare atë punë, më bëri kuadër shumë të rëndësishëm në naftë, me makinë në dispozicionin e pusit, por dhe i ikja asaj pune të mëparshme me turne aq të vështirë dhe me plot rreziqe për jetën. Dhe ajo që ishte më kryesorja ishte fati i gjithë familjes time, duke marrë shtëpi falas në qytet aq shpejt, kur një gjë e tillë asokohe kish qenë si një mollë e ndaluar migjeniane dhe për shumë e shumë naftëtarë më të vjetër dhe më të shkolluar sesa unë.

Mëngjesi i të nesërmes, më gjeti si asnjëherë tjetër të gëzuar dhe shumë më të qartë në mendime, aq sa mërmërisja ngado që ecja e thosha me vete, sesi kishte bërë vaki që më kishin ardhur tërë ato të mira, ashtu aq shpejt, papritur dhe njëherësh të tëra, si me urdhër të peshkut, po ashtu, hapu Susam e mbyllu Susam.

Si i thonë, Nikolla kish vlarë tre zogj njëherësh me mua. Sapo Vlashi hyri në zyrën e tij, qe hera e parë që po e njihja dhe po e dëgjoja atë njeri, ndërsa fjalë bote dija shumë për të, pyeti me një zë të plotë dhe serioz, pa e shqitur për asnjë çast shikimin e tij karakteristik, i qepur ashtu si një shtizë drejt e në bebet e syve të mi:

- Juve ju paskan sjellë këtu, o njeri i mirë?! - ishte pyetja e parë e inxhinierit të shpimit në vend të prezantimit tonë dhe më pas zgjati dorën fare ftohtë.

- Po, - iu përgjigja shkurt dhe po në atë çast e pyeta flakë për flakë inxhinier Vlashin. - Pse, inxhinier, prisnit dikë tjetër?!

- Ooo, jo, more njeri i mirë, jo, kushdo që të vinte pak rëndësi ka pasur për mua, çdo njeri punën e tij do të bënte, atë që ai ka për detyrë të bëjë, dhe unë punën time do të bëj, ashtu si ju tuajën.

Në pamjen e parë Vlashi m'u duk njeri disi i çuditshëm që të ngjallte shëmbëllimin e një njeriu të ftohtë dhe po aq indiferent, ndërsa fjalët e para m'u dukën të ngadalta por të goditura, tepër të sakta.

- Pyeta ashtu kalimthi, - tha ai, - por kur të ziun njeri e ha meraku se me kë do të punojë, mendoj se nuk bëra gabim që ju pyeta ashtu.

Vlashi sapo që ulur në tavolinën e punës, kish nxjerrë nga sirtari i saj librin e madh të shpimit të pusit, aty ku regjistroheshin të gjitha të dhënat e punëve të shpimit të pusit. Tërë ato të dhëna së bashku të shkruara ashtu me imtësi nga vetë inxhinieri i pusit, përbënin vetë historikun e pusit.

* * *

Pastaj Vlashi foli qetë.

- Më kanë folur fjalë të mira për ty, fjalë këto që i kam dëgjuar ashtu kalimthi, - vazhdoi ai, - si i thonë,

i kam dëgjuar pa ndonjë interes të veçantë, ashtu siç mund të keni dëgjuar dhe ju për mua tersin, - ndërsa e dëgjova qartë se aty nga fundi ai e shqiptoi dhe më fortë fjalën ters, me një zë që e dëgjova fare mirë.

E shikoja qetë në sy inxhinierin dhe ndërkohë e mendoja veten time tërësisht të çliruar nga ato mendime aq të këqija që kisha dëgjuar për atë njeri, qoftë dhe nga ato fjalët e Nikollës, i cili më kish porositur në mënyrë të veçantë për atë njeri që asokohe e kisha përballë.

Vlasi e kish zakon që të vështroste qetë dhe vendçe në sy dhe vështtrimin vetvetiu e shoqëronte me një lloj buzëqeshjeje të lehtë gati-gati fëmijërore, që ai kurrë nuk e fshihte për asnjë çast nga bebet e syve të atij njeriu me të cilin ai bisedonte.

Deri në atë kohë Vlasi m'u duk si një njeri krejt tjetër, bazuar në të gjitha ato që kisha dëgjuar për atë njeri. Sakaq në atë kohë m'u kujtua porosia e Nikollës, ndaj dhe vendosa që do ta dëgjoja atë njeri me durim deri në fund, të fliste sa dhe si të donte, dhe unë do ta dëgjoja dhe nuk do ta ndërprisja kurrë.

- Më kanë quajtur si atë, delen e zezë, o njeri i mirë, gjoja se unë jam tersi i të gjitha punëve këtu, mbase dhe i krejt ndërmarrjes.

Sytë e Vlashit u bënë dhe më të dukshëm, ndërsa fytyra i mori një lloj pamje të përflakur tamam si të një shege të porsaçelur, dhe u duk fare qartë se emocionet e brendshme e bënë punën e tyre, ia ndryshuan tërë shprehjen e fytyrës në ato çaste, që

më shumë anonte nga ngjyra paksa e zbardhur, në gjendjen e saj të emocioneve normale.

- Po pse ty, o inxhinier, të quajnë kaq ters, dhe kaq të vështirë në komunikimet me njerëzit, aq sa dhe vetë po e ndien një pasajdisje të tillë, për mos të thënë, një lloj përçmimi, që sigurisht nuk të takon dhe me sa po e vërej dhe unë, në këto pak kohë përgjatë kësaj bisede? Dhe, më fal për këtë pyetje të drejtpërdrejtë që bëra, por ja që unë kështu e kam zakon të flas me të gjithë, veçanërisht me ata të punëve të përbashkëta siç do të jemi dhe ne të dy, - thashë vetëm kaq dhe prita që të fliste ai.

- Jo, ore djalë i ri, - tha inxhinieri, dhe hyri shpejt në bisedë fare pa ndrojtje. - Nuk është krejt ashtu! - Pasi u mendua paksa sikur ai donte të gjente fjalët e duhura në vijim të asaj bisede, që dukej se do të vazhdonte gjatë, tha: - Më parë, o njeri i mirë, më bënin shumë përshtypje disa gjëra që dikush apo shumëkush mendonte keq për mua, apo dhe nuk më vlerësonte, dhe i përgojonte punët e mia. Ndërsa kam kohë që përballë meje këta lloj njerëzish të këtij sorollopi i kam shumëzuar me zero, kam fituar ndaj kësaj race njerëzish atë që dikush në heshtje do ta quante si moskokëçarje, indiferentizëm, “mendje frego”, por unë me një fjalë të vetme do ta quaja “*imunitet*”. Mendoj dhe ende e vras mendjen për të gjithë ata bataçinjtë dhe injorantë, të cilët duan t’i faturojnë tek unë tërë ato cilësitë e tyre që dhe veten e tyre nuk e kuptojnë se cilët janë. Tani, këto shumë

pak më interesojnë, ashtu sa për t'i ditur. Kësisoj e binda veten time në lidhje me njerëzit e tillë, që i futin hundët kudo dhe ndaj kujtdo, kur vetë janë një bajgë e vërtetë.

E pashë Vlashin në sy me njëfarë dashamirësie miratuese paçka pse kish folur ashtu.

- Dhe, meqë jemi këtu tek imuniteti më lejo që t'i them nja dy a tri mendime të tjera në vazhdim, sa për ta ilustruar atë që unë do ta quaja "*imunitet*", sepse dhe kohë kemi mjaft pasi dhe punën nuk e kemi filluar. Të fitosh imunitetin mbi një punë që bën apo mbi një njeri që të sulmon, pa shkak dhe pa të drejtë, dhe kur ti je në të drejtën tënde njerëzore dhe si punë, fillimisht ti do të shqetësohesh por pastaj, me kalimin e kohës dhe me pjekjen e mendimeve të tua, kur ti e mendon se po punon dhe kur ti e kupton se ty po të sulmojnë padrejtësisht, vjen një kohë që në vend të shqetësimit tënd që të shkaktojnë në ndërgjegje, në truallin e asaj ndërgjegjes tënde vjen dhe lëshon rrënjë ajo që shumëkush e quan moskokëçarje, dhe ai farë shqetësimi provokativ a i rremë që ty të ka lënë pa gjumë të ikën, dhe më pas ti çlirohesh nga çdo gjë e atillë dhe pastaj e vazhdon punën normalisht, sikur me ty nuk ka ndodhur asgjë. Ti lufton pastaj ashtu vetvetiu dhe pa e çarë shumë kokën, ashtu si dhe organizmi i ynë që përballet me lloj-lloj bakteresh që duan ta mposhtin njeriun dhe ta sëmurin atë, por është lufta e vetë trupit tonë që bën me ato dhe fiton mbi bakteret, dhe ne nuk sëmuremi edhe pa marrë ndonjë

kurë. Ndërsa ne themi se trupi i atij njeriu nuk sëmuret, thjesht pse ai ka fituar *imunitet*. Por dikush *imunitetin* e quan moskokëçarje, forcë karakteri, guxim për të ecur përpara, apo një mobilizim i vetëdijshëm për të bërë punë të mira, dhe pse njeriut i dalin përpara llojlloj pengesash të padrejta. Por, ama, duhet thënë dhe kjo, ndonjëherë ato lloj kërkesash dhe pengesash janë dhe të drejta, dhe njeriu apo një grup shoqëror i quan ato të padrejta për interes të tyre. Saktë, dhe ata kanë fituar imunitet ndaj atyre kërkesave dhe reagimeve njerëzore. Dhe për ta bërë më të kuptueshëm vetë rrënjën e këtij *imuniteti*, për të cilin ne po flasim, ngrihet një popull i tërë dhe bën greva, siç e kemi dëgjuar të flitet për jashtë vendit tonë. Dhe ata kanë të drejta për sa i përket lirisë, drejtësisë, pagave, mbase dhe për punën që punojnë me orare të zgjatura, apo dhe për vetë gjendjen ekonomike dhe të sigurisë në vendet tyre. Apo e shfrytëzojnë atë popull barbarisht, siç thonë dhe këto materialet e partisë tonë, sa po thuhet se njeriu për njeriun në atë sistem është ujk. Kurse elitat e tyre dhe pse u premtojnë disa herë për t'i zgjidhur ato padrejtësi, sërish ata, as që ua vënë veshin popujve të tyre për ato padrejtësi që u bëjnë, dhe nuk pyesin fare se çfarë thonë për ta. A nuk mund të themi dhe në këtë rast se dhe ata e kanë fituar *imunitetin* ndaj popujve të tyre, por së prapthi, duke e menduar se populli ka të drejtë të bëjë protesta ndaj udhëheqësve që kanë, por sërish udhëheqësisë së tyre nuk u bëhet vonë fare. Madje nuk u bëhet vonë fare

edhe kur ata i vrasin njerëzit gjatë revoltave të tyre për shkak të drejtimit të keq dhe kriminal. Pa le të vijmë në truallin e asaj bisede që na intereson më shumë, se dhe të lodha shumë me këto filozofitë e mia, - tha Vlasi dhe vazhdoi: - Gjërat e mëdha, o njeri i mirë, e duan ndihmën e madhe dhe të ndërgjegjshme të njerëzve të kualifikuar dhe me horizont në të kuptuarin e tyre, ndryshe nga ky realitet që po jetojmë, se asgjë nuk bëhet vetëm, ja për këtë kam nevojë dhe unë. Për kësaj punë më ha kurrizi dhe e di shumë mirë që kjo mendja ime nuk më nxjerrë ters, dhe kur e mendoj kështu me kaq ngulm që ta bëj një punë të mirë.

E vështrova me tërë habinë time atë njeri kur ai po fliste ashtu dhe sërish nuk e ndërpreva, se kisha bërë dhe një marrëveshje me veten time që do ta lija atë të fliste, sa dhe si të donte dhe, aq më tepër, kur po dëgjoja gjithë ato gjëra, shumicën prej atyre mendimeve nuk i kisha dëgjuar asnjëherë më parë në jetën time, ndaj dhe ia bëra me kokë që të vazhdonte, si njeriu që s'do ta humbasë këtë rast fatlum sinqeriteti, mençurie e përvojë jetësore.

- Zaten, ne, ore djalë, vetëm se ecim përpara me punët tona duke i përmirësuar ato, ne nuk po bëjmë ndonjë shpikje të madhe, por dhe aq sa bëjmë në këto kushte në terren, prapë dhe me kaq ne mirë bëjmë. Sepse ligjet e mëdha dhe bazë, për të ecur njerëzimi përpara në çdo fushë të jetës, na i kanë zbuluar dhe shpikur njerëzit e mëdhenj mendjendritur, të mëdhenjtë e kohërave e ne vetëm se po ecim në rrugët

dhe gjurmët e tyre. Do për aerodinamikën, studio Mikelanxhelon, dhe për pikturën po deshe, pesëqind e ca vjet përpara, kujto Da Vinçin, Rembrandin, Pikason, do për të ndërtuar anije dhe vaporë të mëdhenj, studio Paskalin për lundrimet, e kështu më radhë, Ajnshtajnin për relativitetin, Arkimendin për levën e pikën e mbështetjes etj. etj. Dhe për mos ta kthyer këtë bisedë në një shkollë të rëndomtë po ndalem këtu.

Tërë ngjyra e zakonshme në fytyrën e Vlashit kish kohë që kish ndryshuar gjatë të folurit pasionant dhe me fraza të mbushura plot dije dhe logjikë.

- Tani po ta rrëfej tërë mendimin tim që më vlon në kokë, të cilin e kam biseduar dhe me të tjerët. Ta thashë pak më parë se unë jam inxhinier, - tha Vlashi me plot gojën, - dhe dua që ta bëj dhe unë një punë të mirë si inxhinier që jam. Por, për t'u bërë inxhinier i mirë nuk bëhesh dot vetëm me fjalë dhe me atë djall shkolle që ti ke bërë, po nuk punove në praktikë dhe po nuk lexove sistematikisht, dru i pagdhendur ngelesh, apo dru fiku i njomë që nuk bën as për të djegur. Dhe do të vijë një kohë dhe ti nuk do të jesh më për asgjë, apo dhe më keq, duke fjetur gjumë si derri i ngopur në kotec para dhe pas pune, e ku do t'i gjejë njeriu i shkretë tërë ato dituri dhe kur koha kalon, dhe çdo gjë ndryshon për më mirë e më mirë, shkenca përparon dhe ty të lë koha prapa, nëse fle gjumë apo nuk këmbëngul që

ta provosh veten tënde, në punë e sipër dhe në punë të mëdha, se sa ti vlen në të vërtetë.

* * *

- Troç, o Skënder, - tha Vlashi, - njeriu po nuk qe novator dhe i dashuruar pas punës së tij, pse jo të shohë dhe ëndrra në gjumë, më vjen keq ta them, por ai njeri punon sa për bukën e gojës. Dhe, të rrosh në këtë jetë si një njeri i tillë, është vërtet mëkat i madh, kur dijet e tua nuk i vë në shërbimin e të mirës, qoftë dhe për vetë sedrën tënde, se dreqi e mori, je specialist apo çfarë djalli je? Pikërisht, nga këto cilësi ndryshojmë ne njerëzit nga kafshët, sepse Zoti apo natyra nuk na ka bërë sa për të gjetur rrugën, por ne shohim, dëgjojmë, mendojmë, gjykojmë, fantazojmë, si për të keqen dhe të mirën. Pastaj ne, njerëzit, kemi privilegjin e madh të një kujtese personale dhe kolektive që, dhe nëse gabojmë, i ndreqim gabimet tona, punët e bëra keq sot i bëjmë më mirë nesër, se kështu është i ndërtuar njeriu, sa i mirë por dhe aq i gabueshëm, gabimet dhe fajet në jetën e tij janë të pashmangshme.

Vlashi fliste, unë mendohesha i habitur, veçanërisht kur i dëgjoja tërë ato fjalët e tij të zgjedhura dhe të përpunuara, të cilat po i dëgjoja me aq kujdes nga goja atij njeriu aq i përgojuar, i sharë dhe aq i pasajdisur, që mbante mbi veten e tij tërë ato epitete. Ndërsa sipas mendimit tim, Vlashi, po më dukej

krejt i ndryshëm nga tërë ato të thënat e botës, që unë kisha dëgjuar, aq sa kisha marrë dhe porosi të veçantë nga Nikolla.

- Ne nuk e kemi filluar shpimin e pusit akoma. Kjo është e tërë tema e kësaj bisede që do t'ju flas tani dhe për këtë të lutem më dëgjoni me tërë kujdesin tuaj të respektuar. Para se ta fillojmë shpimin e këtij pusi, unë kam menduar që ne të bëjmë disa ndryshime të dukshme në projektin e pusit. Këtë gjë që po jua them, ua kam thënë dhe të tjerëve dhe, për çudi, nuk kam marrë përgjigje. Mbasi ju ta mendoni mirë dhe qetë mendimin tim, mundësisht ma jepni dhe përgjigjen tuaj, për ato ndryshime që unë po mendoj të bëj në projektin e pusit.

Vlasi që vërtet njeri i zgjuar, gjatë gjithë bisedës ai të ndiqte në çdo fjalë me kujdesin më të madh, madje dhe me shprehjen e fytyrës.

- Ajo që kam menduar unë, o njeri i mirë, o shoku im i punës, i kësaj pune vërtet të madhe që ne duam të bëjmë bashkë, fillimisht e mendoj se do na bënte me vlera të mëdha e jo për t'u dukur, por do të ishte vërtet një revolucion i madh tekniko-shkencor në shpimin e puseve në përgjithësi, në këtë zonë kaq të madhe dhe të re të gazit. Ne do të kursenim vlera të mëdha monetare dhe bazë materiale, gjithmonë sipas asaj që mendoj unë. E, kur tërë ajo bazë materiale vjen me aq vështirësi nga jashtë e me valutë, dhe ato janë tuba rrethimi të çelikut, rëndues për solucionin e argjilës, bariti dhe piriti, dhe reagjentë të ndryshëm,

që të gjitha këto ti i di se kushtojnë sa qimet e kokës dhe s'i gjen dot, por kjo është punë tjetër se me ato punë për sigurimin e tyre merren të tjerët, mjafton të të them kaq, por mos u habit me këto që po them tani, për tubat e rrethimit, baritin, dhe tërë reagjentët, pa i llogaritur ato shpenzimet e prurjes nga jashtë, ne na duhet të bëjmë maksimumin për kursimin e tyre.

Ndërkohë Vlasi heshti sërisht, sa përflakja e një vetëtime, sikur ajo vetëdija e tij e ndrojtur në atë kohë t'i thoshte: Mos i zvarrit më mendimet e tua, se po e bën vërtet si puna e llastikut, që zgjat e zgjat po ku do ta çosh më, sa ta këputësh fare, a nuk e kupton se ai njeri ka kohë që po të dëgjon si shumë dhe pa të njohur fare se kush je.

Dhe po në atë çast ai foli qetë dhe i përflakur i tëri në fytyrë.

- Ne do të shponim më tepër se një pus tjetër falas, me ato kursimet që do të fitonim nga puna që duam të bëjmë, - tha Vlasi dhe në atë çast ai pushoi, dhe qe duke parë ashtu vençe nga unë.

- Falas the? - fola unë me vete gati i pavetëdijshëm, ndërsa m'u duk se isha si në një ëndërr me sy hapur dhe sikur po thosha me vete. Ky njeri, ose di shumë dhe është vërtet mendjendritur, ose është tamam ashtu siç e tregojnë, është një njeri xanxar dhe një fyell pa vrima.

Nuk e fsheh, në atë çast kisha filluar që të dyshoja paksa te Vlasi dhe, po në atë çast, tërë ato mendimet

e këqija që kisha dëgjuar për të, sërish më ishin mbledhur në mendje tamam si ato bletët në koshere gjatë gjumit të tyre. Edhe vetë Vlasi kishte pushuar në atë çast sa u duk se ai u mbush mirë e mirë me frymë.

Tërë ajo dëshirë e madhe e tij për ta bërë atë punë dukej se i ishte mbledhur bashkë me nurin e bukur të fytyrës në ato çaste, ndërsa sytë e tij të qepur në bebet e syve të mi, po ndrinin shkëlqyeshëm si dy gurë xhevahiri, kurse unë ende po e paragjykoja atë njeri, edhe në ato çastet e gëzimit të tij.

Vlasi e tha dhe njëherë atë fjalën falas, por më me forcë dhe me krenari, pastaj ai u duk se u ndie tërësisht i çlodhur dhe i qetë.

- Më shkurt, unë e mendoj kësisoj, - rinisi ai të flasë. - Në këtë pus, që të bëjmë përjashtime nga të gjithë pusët që janë shpuar në këtë zonë, mendoj të ulim një konduktor paksa të gjatë, në vend që të ulim një kolonë rrethimi deri në 2000 apo 2500 ml, siç janë ulur deri më sot në këtë zonë. Dhe, kështu ne, do të kursejmë shumë bazë materiale, tuba rrethimi, rëndues dhe reagjentë, kryesisht nga ata që vijnë nga jashtë.

Ndërsa unë e shikoja vazhdimisht Vlashin në sy dhe ndërkohë mendoja herezinë e ndërrimit të projekteve në shpimin e puseve në atë zonë shpimi të vështirë, çka ishte gati-gati utopi. Dhe, ashtu siç e kish menduar Vlasi që të punohej në atë pus, edhe mua vetë po më dukej e pamundur. Vështirësitë e asaj

zone i njihja dhe më nga afër se çdo njeri tjetër, njihja deri në detaje tërë ato tekat e asaj nëntoke. Atje, në atë zonë gazi, kisha punuar me vite të tëra si sondist. Kushedi sa e sa puse qenë bllokuar dhe kishin ngelur në avarira të palikujduara, madje disa puse patën fontanuar dhe patën djegur edhe sondën e shpimit.

Nga ana tjetër po arsyetoja, se ashtu siç e kish menduar Vlashi, nga tërë ai zinxhir thjeshtimesh teknologjike, ne do të rrisnim shumë shpejtësinë sondë - muaj të shpimit, mbase dy apo tri herë, në referim me shpejtësitë e para sondë - muaj të puseve që ishin shpuar në atë zonë shpimi. Në atë mënyrë të veçantë që propozoj ne do kursenim dhe atë që njerëzit nuk e llogarisin aq shumë, siç duhet, që është koha, do të kursenim dy apo trefishin e asaj kohe që do të duhej të shpohej një pus deri në atë kohë. Gjithë ato kurse do na shoqëronin gjithandej, si në një reaksion zinxhir, ashtu kish thënë Vlashi.

- Ky është i gjithë ai ndryshim dhe e tërë ajo që doja të të thosha. Pra, mendoj që mos të përdorim fare rëndues, ose të kemi një kontingjent rezervë sa për ndonjë të papritur, por jo ta përdorim, - vazhdoi Vlashi, - dhe solucionin e argjilës ta mbajmë vetëm me RQS, ujë plus qymyr dhe sodë kaustike, dhe reagjent vendi KMC. Kështu shmangim importin duke e reduktuar në maksimum tërë atë bazë materiale. Pikërisht kështu, i ndryshojmë traditën e asaj pune të vjetër, për të cilën po flasim, kursejmë rënduesit, ferrokromin, KMC-në e jashtme, plus tubat e rrethimit të çeliktë që janë aq të vlefshme.

Vlasi i zbrazti të gjitha ato që kishte për të thënë. Pastaj ai u ul, vuri të dyja duart mbi librin e shpimit të pusit, të cilin e kish nxjerrë prej kohësh mbi tavolinën e tij të punës. Ndërkohë vura re se po priste me padurimin më të madh, që të më dëgjonte mua.

Natyrisht donte të më dëgjonte për disa arsye kryesore: e para ai donte të dinte se me çfarë njeriu do të kishte të bënte në të ardhmen; kush isha unë i vërteti në ato punët për shpimin e puseve, sa peshoja në sytë e tij, dhe në lidhje me likuidimin e avarive, dhe se sa do ta vlerësoja propozimin e tij.

- Edhe unë po të dëgjoj po më të njëjtin respekt, - foli Vlasi, të cilin e kuptova qartë se deshi të më nxiste, që të flisja sa më parë.

- I nderuar inxhinier, - i fola ngadalë, qetë dhe në afinitet bashkëshoku në punën tonë kaq të vështirë. - Për sa i përket propozimit tuaj të cilin e vlerësoj mbasi jam aq në gjendje që ta vlerësoj atë më së miri. Nuk kam pse ta fsheh, propozimi i juaj e ka dhe çudinë dhe habinë time brenda, të dyja bashkë, po dhe të shumë njerëzve dhe specialistëve të tjerë në punën tonë. E çmoj pa masë propozimin si një ndërmarrje shkencore më vete, që do të ishte një hop kaq i madh cilësor, në ecje e sipër të puseve në tërësi në këtë zonë. Propozimi i juaj është aq i leverdishëm dhe po aq mendjehapur tekniko-shkencor, saqë ai do t'i vlente punës sonë në të ardhmen, sa më s'bëhej; dhe kjo do të ishte më kryesorja. Por një ndërmarrje

punimesh e tillë për ne të dy, inxhinier, unë si një drejtues i ri në këtë pus, juve si një inxhinier e drejtues teknik i përgojuar, nuk ju vjen rëndë se po u flas kështu...

- Jo, - tha duke më ndërprerë Vlasi.

- ... do të ishte vërtet një guxim shumë, shumë i madh dhe tepër i vështirë për ne, në këto kushte për të cilët fola, por ama, në këtë botë, nuk ka asgjë të perealizueshme dhe të pakalueshme, sigurisht po ta vrasësh mendjen dhe të punohet po me dije dhe guxim.

- Domethënë nuk mund të realizohet? - tha aty për aty Vlasi, gjithë dyshim e i rënë fare moralisht, aq sa dhe në sy nuk po më shikonte në ato çaste.

- Jo, inxhinier, - thashë shpejt, pa bërë as pauzën më të vogël, - atë ende nuk e kam thënë, - vazhdova të flisja pa u ndalur. - Punët kaq të mëdha dhe me përgjegjësi, i nderuar inxhinier, duhen parë dhe analizuar me kujdes në çdo hap që duhet hedhur, se çdo gabim tonin, nesër nuk do na e falte njeri.

- Atë e di mirë unë, - foli si nëpër gjumë Vlasi, - se sa u dënuan dhe u përjashtuan nga partia në atë pus. Por dhe pa guxim kurrë nuk ecet përpara!

* * *

- Ndërsa unë e shoh bindshëm suksesin e madh si një dritë neoni para syve të mi, - vazhdoi të fliste

Vlashi, - ose më mirë të them, se një përfytyrim i tillë ëndërrues po më çon drejt e në derën e një pune të madhe. Por siç e thashë, çelësin e magjishëm për ta hapur atë derë e keni vetëm ju, ndërsa për të shkuar deri tek ajo punë e madhe, që unë e mendoj se është në ishullin misterioz të mendimeve, në kokën tonë, teorikisht deri atje po u çoj unë, praktikisht ju. Dhe kështu së bashku ne do ta zbulojmë atë thesar aq të vlefshëm dhe të madh, dhe ai thesar mund të bëhet i tillë, i yni, vetëm me guximin, burrërinë e me këmbënguljen tonë.

- Kaq romantik nuk të dija, o inxhinier, - i thashë me atë afinitet, që ishte krijuar tashmë dhe dashamirësi, pa asnjë hipokrizi, thjesht për t'i bërë qejfin atij në atë kohë. Për arsye të një pune tjetër të ngutshme e lamë aty atë bisedë, që s'të bie shpesh rasti ta bësh me atë konfidencialitet e besim reciprok të sapokrijuar si të ishim miq të vjetër.

Në zgjimin e ditës së tretë u ndjeva shumë i sikletshëm. Arsyeja e vërtetë ishin shkaku i vetëm i asaj bisede që kisha bërë me inxhinier Vlashin, bisedë e cila më kish bërë aq të ndjeshëm sa të vrisja mendjen seriozisht për atë propozim me aq vlera që kisha dëgjuar prej tij, për tërë ndryshimet madhore në projektin e pusit, për reduktimin thuajse drastik në konstruksionin e pusit dhe në ndryshimin rrënjësor të tipit të solucionit të argjilës, që në shpimin e puseve quhej si gjaku i njeriut për trupin e tij.

Vlashi për mua deri në atë stad njohjeje ishte njeri i mirë, inxhinier i zoti e novator i vërtetë që rrallë kisha takuar një specialist të atillë të guximshëm, sa ai.

Përkundrazi kisha njohur më shumë specialistë të ndrojtur dhe frikacakë, kur bëhej fjalë për gjëra madhore, veçanërisht në ndërhyrjet e projekteve të pusit për lehtësimin e konstruksioneve të tyre, kërkohej që ato projekte të visheshin në mbrojtje dhe me masa të tjera plus për gjatë gjithë shpimit të pusit. Gjykova se ajo konsideratë imja për inxhinierin patjetër do të duhej të provohej në praktikë, siç dhe u provuan në pusin D. 5 Bizë, në zonën D, pranë ultësirës të Adriatikut.

Disa ditë më vonë pas atij vendimi aq të madh, ne i filluan punimet për shpimin e pusit po me të njëjtin vendosmëri dhe përkushtim, siç e kishim menduar. Për t'i çuar deri në fund punimet për shpimin e atij pusit dhe me miratimin gojor të Nikollës dhe të disa projektuesve, shpejt u shpuan 900 ml dhe u tubuan ato metra shpimi me tuba rrethimi 9-polshe.

Dhe, më pas, gjatë gjithë kohës, puna eci mirë dhe për mbarë, me shpejtësi më të madhe nga çka e kishim parashikuar ne...

Mirëpo siç ndodhte rëndom në naftë, për neglizhenca dhe thyerje disiplinore, pusi D35 ra në avari të rëndë në fundin e metrave të tij. Qe kuje e zezë për të gjithë punonjësit e atij pusi, në veçanti për tre veta; për mua, Vlashin, dhe i treti që nuk e priste një dështim të tillë, ishte vetë Nikolla.

Vetë atë, me siguri do ta paragjykonin për përzgjedhjen time në atë detyrë aq të vështirë, në një moshë të re dhe pse ai e kish bërë atë përzgjedhje. Kish ndodhur si një rrufe në qiell të hapur ajo avari e nuk pritej nga asnjë.

Pusi që bllokuar keq, tërë instrumenti i shpimit nuk lëvizte fare, ai nuk vinte lart, nuk shkonte as poshtë, as nuk xhironte, që një bllokim total dhe fati i atij pusi nuk dihej më nga askush, nëse do të zhbllokohej më dhe, për mendimin e përgjithshëm inxhiniero-teknik, ajo lloj avarie pritej të ishte dhe fatale.

Por më e keqja që se, në rastin e asaj avarie, do të hapeshin diskutime të mëdha, kur njerëzit që kishin pritur të ndodhte ajo lloj avarie, pikërisht në fillimet e punës në atë pus, ata do ta quanin thjesht si mendjemadhësi, nxitim, një punë e bërë pa e gjykuar mirë, punë e bërë me ngutje, e papjekur vetëm për të fituar famë.

Kish qenë një faj tepër i rëndë dhe po aq banal i sondistit, duke marrë një sy gjumë në turnin e tretë. Ai e kish lënë palëvizur instrumentin e shpimit për një kohë të gjatë. As që bëhej fjalë fare për respektim të rregullave.

Një neglizhencë e tillë e pafalshme e kish çuar atë pus me aq rëndësi dhe me një pritshmëri aq të madhe, drejt likuidimit përfundimtar si pus e, së bashku me pusin, do të shuhej si një yll i rënë nga qielli, pa lënë asnjë gjurmë, edhe tërë ajo punë aq e mirë e gjithë punonjësve të shpimit të pusit, bashkë dhe me atë

novacionin e Vlashit me aq leverdi, që kish bërë aq bujë deri në atë kohë dhe kishte zgjuar interesim të madh.

Por kish edhe shumë të këqija të tjera, që nuk mbaronin, po për shkak të asaj avarie; do të vonohej shumë sqarimi i asaj zone gazi, goxha e madhe dhe e suksesshme, e cila po pritej me padurimin më të madh nga partia dhe qeveria në qendër, thjesht, për të marrë sa më parë metra kub gaz. Në raste të tilla, nuk të falej grami i fajeve në punë, pale të likuidohej pusi, ishte vërtet një kujë e zezë. Sapo që bllokuar pusi, Vlasi e kishte nisur urgjentisht makinën e pusit në qytet, për të më marrë në shtëpi. Ndërkohë që njoftuar ndërmarrja, ndërmarrja njoftonte menjëherë drejtorinë e përgjithshme të naftës, dhe asisoj shkonte ai lloj njoftimi me radhë, deri në ministri, po në atë të mënyrë e ritëm të shpejtë njoftoheshin dhe strukturat e partisë dhe të shtetit.

Shpejt, në raste avarish, mbushej sheshi i shpimit me makina të vogla dhe popullohej i tëri me lloj-lloj njerëzish, nga njoftimi që merrte formën e një reaksioni zinxhir.

Më shpejt në ato raste në pus mbërrinin njerëzit e strukturave drejtuese të naftës; pas tyre vinin punonjësit e partisë dhe të shtetit të aso kohe, ngaqë pusi ishte me rëndësi të madhe. Mblidhej i gjithë ai millet si në rastet e morteve të rënda familjare dhe, nga ai çast, pritej lajmi i keq apo i mirë, siç ndodhte dhe për të sëmurin rëndë, që do të ngjallej më ai

njeri apo jo, kur të gjithë sy e veshë e përgjonin andej nga mund të vinte lajmi. Lajmi i mirë ishte, vetëm zhbllokimi i avarisë.

Të tilla qenë ato siklete dhimbjesh që përjetoheshin shumë keq, kur avari të tilla krahasoheshin saktë, nëse pusi humbiste, si një vdekje e trishtë, e dhimbshme aq sa e një njeriu të ri. Sepse pusi i ngelur në avari sillte shumë drama të mëdha për shumë njerëz të veçantë, dhe si kolektiv punonjës.

I pari në pus mbërrita unë, më pas Nikolla, kryeinxhinieri, bashkë me shefin e avarive të ndërmarrjes, avarishpëtuesin. Në atë kohë kisha filluar nga manovrimet e para për zhbllokimin e pusit, pa pritur që atë punë ta kryente avarishpëtuesi.

- Të lutem, Skëndere, më dëgjo me kujdes, tani bëj çfarë di më mirë të bësh, si të mësojnë ato instinktet e vetëdijes tënde profesionale, - tha Nikolla, që dukej se vuante shpirtërisht, kur ai i nxirrte fjalët nga goja si me përtim dhe një e nga një. - Nga kjo djall avarie duhet dalë patjetër, - tha Nikolla i trishtuar, para se të largohej nga aty, pranë meje në pultin e komandimit të sondës. - Puno i qetë dhe mos e humb toruan.

I bëra me kokë Nikollës që të largohej, se pikërisht në atë kohë, kur punohej për zhbllokimin e avarisë, me vetëdije kisha bërë marrëveshje me vetveten që, dhe mund të vdisja gjatë asaj pune për likuidimin e avarisë - dhe tragjedi të tilla të shumta kishin ndodhur në naftë - ndërsa dhe mua vetë sa herë më kish shpëtuar vetëm fati. Nisur nga tërë ato raste aq

të vështira e mendoja se kisha fituar imunitet ndaj çdo procesi pune të sondistit, dhe veçanërisht në zhbllokimin e avarive. Ndërkohë mëngjesi i asaj dite dukej se po jepte shpirt. Një palë re arrakate tepër të nxira lëviznin si me ngut në drejtim të perëndimit, çka dukej dhe nga forca e erës, e cila sapo kish nisur të frynte ashtu lehtë-lehtë.

Askujt nuk do t'i shkonte në mendje se së shpejti do të kishte përkeqësime të kohës. Sepse ishte shumë e rëndësishme në rastet e avarive një mot i mirë, pasi moti i keq ndikonte shumë negativisht gjatë manovrimeve për zhbllokimin e pusit, vështirësohej shumë puna e punëtorëve dhe e vetë manovruesit.

Qe tamam ajo koha kur po dukej se të gjithë e kishin humbur shpresën për daljen nga ajo avari, duke filluar nga të mëdhenjtë e teknikës, që kishin ardhur enkas, por i besonin vetëm rastësisë që avaria e shëmtuar të zhbllokohej. Të mëdhenjtë e teknikës kishin kohë që diskutonin; flitej që pusi të kalonte në një punim tjetër, në një banjë të sforcuar me naftë.

Ky proces ishte i tillë që, duke futur naftë të hollë në një lartësi të llogaritur në trungun e pusit, në zonën e bllokuar, nafta e lënë në qetësi për disa orë i zbuste faqet e trungut të pusit dhe, për pasojë, lehtësohej lëvizja e instrumentit të shpimit nga faqet e trungut të pusit, gjithmonë duhet menduar se trangu i pusit është vetë pusi i shpuar.

Thjesht bëhej fjalë për vrimën e shpuar deri në thellësitë e parashikuara sipas projektit të pusit. Ai

quhet trangu i pusit, që pas shpimeve në etapa të ndryshme, toka vishet me kolona rrethimi tuba të çeliktë, njohuri këto të përimita inxhinierie, të cilat janë më të kuptueshme për të gjithë ata që kanë punuar e punojnë ende në naftë.

I kisha bërë të gjitha ato që i kisha menduar, me xhirime dhe tërheqje të sforcuara, sa mund të këputej instrumenti i shpimit apo dhe mund të ndodhte ndonjë shkatërrim tjetër në makineri e në mjetet ngritëse, dhe e tërë ajo punë e bërë deri në atë kohë aq e sforcuar ende pa rezultat.

Në atë kohë më erdhi si me porosi fati, i cili shumë herë më kish ndihmuar në raste të tilla. Kujtesa ma solli të freskët para syve të mi një lloj bllokimi të ngjashëm, që më kish ndodhur kur punoja sondist, në njërin nga pusët e vështirë, me kapërcime gradienti të ujërave nëntokësore.

Dhe duke vepruar si në atë rast, për fatin tonë të madh, pusi u zhblllokua.

Në raste të tilla një rol vendimtar dhe, sidomos, në zhbllokimin e avarive, luan edhe gjendja tekniko-mekanike e sondave të shpimit. Përgjegjës për këtë ishte kryemekaniku i sondës A. Balla, i cili kujdesej që sonda e shpimit të ishte gjithmonë në gjendje të mirë, së bashku me personelin mekanik të pusit si: Zh. Sinani, N. Hasalla etj.

Gjithashtu, rol të veçantë luan edhe gjendja e mirë dhe mirëmbajtja e solucionit të argjilës, që siç thuhet është si gjaku i njeriut, për mirëmbajtjen e trungut të

pusit. Për këtë arsye, përveç personelit inxhinieroteknik të pusit zbrisnin herë pas here në bazë edhe inxhinierë nga Instituti i naftës në Patos, Fier, të cilët ishin nga inxhinierët më të specializuar për solucionin e argjilës, drejtues të laboratorit, ing. S. Karajani, F. Shehu, më pas edhe dr. prof. ing. V. Fili, N. Limaj etj., si dhe një armatë e tërë teknikësh dhe inxhinierësh nga ndërmarrja, pa lënë pa përmendur këtu edhe rolin aktiv të N. Kicos dhe të gjithë drejtorëve, ing. J. Cale, ing. S. Molla, më jetëgjati në ndërmarrje, apo edhe të kryeinxhinierëve H. Qallija, P. Hoxha etj., të cilët e mbanin në këmbë ditë e natë ndërmarrjen e shpimit.

* * *

Çaste gëzimi të papërshkrueshme në ato momente të daljes nga avaria kur shihej se dhe vetë makineritë dhe sendet po gëzonin. Përjetime e aso lloj ndjesish emocionale në çastet e zhbllokimit të pusit nga avaria, shumë pak njerëz i provonin. Për çaste të tilla çlirimi nga stresi i koncentruar e i frikshëm di të flasë vetëm ai person që merret drejtpërdrejt me zhbllokimin e avarisë.

Vura re me kujdes, pas zhbllokimit të avarisë, kur ika nga pulti i komandimit dhe zbrita poshtë në sheshin e shpimit, se nuk kishte qoftë dhe një njeri të vetëm ashtu të mendueshëm e nën stres, por njerëz të qeshur dhe të gëzuar, shihja në ato çaste, se edhe

vetë qielli po më dukej se kish marrë formën si të një pasqyre konvekse gjigante dhe tepër i kthjelltë. I pari që më takoi pas avarisë qe Nikolla. Më tha vetëm kaq:

- Të lumtë, djalë, nuk më zhgënjeve, hallall i paç të gjitha dhe atë besimin tim të patundur për ty.

Ndërsa kryeinxhinieri i ndërmarrjes, një burrë babaxhan, i gjatë dhe i drejtë si kavak, me fytyrë të plotë e disi të hequr, me tipare burrërore, me një hundë të gjatë dhe të drejtë, që kurrsesi nuk mund t'ia quaje të madhe dhe të shëmtuar, në prani të Nikollës, tha:

- Nikollë, nuk i ngel gjë në dorë për keq këtij njeriu, si asnjëherë tjetër. Aftësitë dhe praktika të këtij lloji nuk përfitohen as me shkollë të madhe, kur njëherësh duhet të gjykosh dhe të veprosht drejt në ato momente tensionesh aq të mëdha, që ndodhin në ngritje dhe në përdredhjet e instrumentit të shpimit, dhe kur frika ta mban vdekjen gjithmonë para sysh. Avaritë kanë ndodhur dhe do ndodhin gjersa të jenë dhe vetë shpimet e puseve me gjithë historitë e tyre për naftën dhe gazin; avaritë janë pjesa më e keqe e vetë trungut të pusit të shpimit që i stimulojnë ato, të ushqyera dhe nga vetë gabimet njerëzore. E para, duhet të dish të hysh në lidhje imagjinare me avaritë, - vazhdoi ende të fliste Haxhiu, - duhet të dish të fantazosh dhe t'i perceptosh qysh më parë të gjitha ato punë dhe veprimet e njëpasnjëshme dhe në sinkron, që ti do të bësh më pas. Dhe, në të njëjtën kohë, në fraksionet e sekondave, ti të jesh në gjendje që të presësh

përgjigjen imediate të atyre sforcove tej mase, dhe me intuitë dhe parandjenjë, të vendosësh ç'të bësh, që të ecësh më tej, apo ta ndalësh fare punën tënde, kur ti je duke manovruar me tërë sigurinë dhe gjithmonë duke e menduar për mirë. Dhe kur e di se kur ajo punë të del gocë, dhe në ato raste nuk ka burrë nëne mbi dhë që t'i falin dëme të atilla, dhe me aq pasoja. Ndaj dhe shumë puse të shpimit kanë ngelur në avarira të palikuidueshme vetëm se nuk veprohet me guxim dhe aty për aty, Nikollë, por pritët nga drejtuesit e pusit sa të vijnë të tjerët për ta bërë punën e tyre. Dhe e fundit fare, Nikollë, këtë pus na e shpëtoi po ky djalë, ndryshe pusi do na e vinte vulën e keqe të gjithëve, si neve të teknikës dhe ndërmarrjes, në përgjithësi, për organizimin e punëve.

Kaq u desh të thuhej nga kryeinxhinieri i ndërmarrjes Haxhi Qallija, që ata të largoheshin nga pusi për në ndërmarrje, Nikolla, kryeinxhinieri, bashkë me avarishpëtuesin.

Sa më shumë ta shikoje me vëmendje Haxhiun, aq më shumë të ngjallej ndjenja pozitive për njeriun e mirë, burrëror, i qetë, fjalëpakë dhe i logjikshëm. Të impononte një ndjenjë respekti dhe, çuditërisht, me t'u larguar prej tij të kaplonte ndjesia e mallit. Haxhi Qalliun e quanin njeriun me tipare dhe veçori të rralla, të cilit koha e gjatë e punës në naftë, i kishte falur përvojë pune të madhe.

Sigurisht, në atë kohë, ne të gjithë sapo kishim shpëtuar nga një siklet i madh i radhës, por si gjithmonë

në naftë, në punë të atilla, rreziku bashkëjetonte me frymëmarrjen e vet njeriut të përgjegjshëm për ato punë. Nuk vonoi shumë dhe ai pus u vu në shfrytëzim, i cili dha gaz, po me ato presione dhe pikësnyimet e parashikuara në projekt.

Nuk kishte gëzim më të madh për të gjithë punonjësit për shpimin e atij pusi, për Vlashin më së pari dhe mua që nga ajo punë e madhe e nisur me bindje dhe vendosmëri qysh në fillimin e pusit, me propozimin aq të vyer të Vlashit, dhe e mbështetur nga puna e suksesshme që dha atë rezultat pozitiv e inkurajues për ne.

Dhe, nga vetë ndërmarrja e shpim-kërkimit në Lushnjë, pusi kish mbaruar me sukses, kurse ekonomia e vendit do të fitonte aq shumë në të ardhmen në shpimet e puseve, do të fitohej thjesht nga ai lehtësim i konstruksioneve që kishin qenë aq të rënduara më parë, me ato gjatësi kolonash teknike, 2000 deri 2500 ml, që në të ardhmen nuk do të uleshin si më parë. Leverdia ishte e madhe.

Do të kursehej tërë ajo bazë materiale, siç qenë tubat e çelikut, rënduesit, bariti, piriti, dhe reagjentët e ndryshëm që përdoreshin për mirëmbajtjen e solucionit të argjilës të puseve, pasi në atë pus, siç rrëfeva, u ndryshua rrënjësisht tipi i argjilës të pusit dhe, ashtu do të vazhdonte ajo punë në tërësinë e saj, në të gjithë puset që do shpoheshin më vonë në atë zonë të re gazi.

Nga të gjitha ato kursime që vinin si shkak i atij eksperimenti dhe asaj pune do të shpoheshin dhe

dy puse të tjera falas, për sa u përkiste kolonave të rrethimit dhe bazës materiale, pa folur fare për rezervën më të madhe të kohës, për kursimin e pagave bazë të punonjësve në zgjatjet e kohës, të cilat do të kurseheshin dhe si rezultat i shpimit të puseve shpejt, mirë dhe pa avari, të lehtësuar në konstruksionet e tyre dhe për vetë tipin e solucionit të argjilës. Kish qenë i pabesueshëm më parë, dhe u duk si një habi e madhe kur doli në pah i realizuar propozimi këmbëngulës i Vlashit.

Pusi mbante emrin D35B. Në zonën D, pranë ultësirës të Adriatikut. Vlerat madhore pusi i mori thjesht për thyerje të tabëve në lehtësimin e konstruksionit të puseve, dhe të lëngjeve larëse.

Pus i cili solli një progres të madh tekniko-shkencor, me përfitime të mëdha në kursimin e kohës në shpimin e puseve të më vonshëm. Dhe së fundi u kursyen vlera të mëdha monetare, kur u përfituan më shpejt metra kub gaz që me aq ngut kërkoheshin aso kohe.

Qe pusi i pari dhe i fundit që u shpua nga unë dhe Vlasi. Për arsyet e veta familjare, Vlasi kish kërkuar kohë më parë që të punonte po si inxhinier shpimi pranë familjes, në ndërmarrjen mëmë të shpim-kërkimit të naftës në qytetin e Kuçovës.

Më pas, rreth vitit 1991, jeta e atij njeriu aq e vlefshme për veten dhe familjen e tij, u shua befasisht në një aksident tragjik, tepër i dyshimtë, gjatë një udhëtimi me motor. Nderime të paharruara dhe respekt për atë njeri mendjendritur.

Në të njëjtën kohë, do t'u kërkoja të falur të gjithë familjarëve për përmendjen e emra konkretë të njerëzve të tyre të dashur që janë larguar nga kjo botë, duke pasur gjithmonë në mendje, thënien të Volterit të madh: “Të gjallëve u kemi borxh respektin, ndërsa të vdekurve vetëm të vërtetën”. Njerëz të tillë nuk jetojnë më, por puna nderi dhe lavdia e tyre e punës ngelet e paharruar në memorien time dashamirëse për ta.

Pusin e ri e fillova me një mangësi të madhe, pa Vlashin, siç e thamë më lart, ai që larguar për të punuar në ndërmarrjen e naftës, në Kuçovë pranë familjes. Vendin e Vlashit e zuri një inxhinier tjetër, ai nuk i ngjante Vlashit, por mjaft që kish vullnetin e mirë për punën dhe bënte tutje.

Në ato kushte mua vetë dhe të gjithë punonjësit e shpimit në pusin e ri na duhej që të ishim dy herë më të kujdesshëm gjatë shpimit të atij pusi, si pus i dyti për mua në atë detyrë të mbaronte më mirë sa i pari. Që pikërisht ajo kohë pas viteve shtatëdhjetë kur ndërmarrjen e shpim-kërkimit për gaz në rrethin e Lushnjës e drejtonte njeriu punëtor dhe i talentuar, ish-drejtor i ndërmarrjes, N. Kico, për të cilin kemi folur më lart dhe ende do të flasim me kalimin e kohës, i cili do t'i rroki të dy kohët e sistemeve.

Ndërsa fushat dhe kodrat e pyllëzuara aso kohe oshtinin nga uturimat e sondave të shpimit. Të gjitha rrugët në atë varg kodrash të pyllëzuara qenë të shtruara

dhe shtroheshin enkas nga dita në ditë me çakëll për çdo pus shpimi, ndaj ato rrugë dhe sheshet e shpimit të puseve zhurmonin ditë e natë nga puna e sondave të shpimit dhe makinat e tonazheve të rënda që sillnin materiale për sondat e shpimit dhe punëtorët, ku shihej dhe ndihej gjallëria e jetës njerëzore natë e ditë.

Asokohe ishte një plejadë e shkëlqyer punëtorësh, teknikësh dhe inxhinierësh që i jepnin tonin asaj pune aq të madhe që bëhej. Çdo gjë bëhej me dije dhe guxim kur thyheshin rekorde pas rekordi në shpimin e puseve dhe në përvetësimin e tyre.

Të tillë qenë individët që mund të kujtojmë brenda asaj armate të madhe njerëzish, që nga vetë Nikolla Kico, promotori i ndërmarrjes dhe personazhi kryesor i këtij tregimi të gjatë dhe, me radhë, inxhinierët e talentuar: ing. H. Qallija, V. Verdha, R. Shllaku, J. Cale, S. Molla, P. Hoxha, N. Limaj, M. Mbrice, R. Lavdari, ish-drejtorë këta dhe kryeinxhinierë ndërmarrjesh: ing. L. Feracaku, A. Nushi, E. Ago, K. Mitrushi, L. Mece nga fundi, gjeologët: I. Halimi, T. Bardhi, K. Saraçi, A. Halili, ing. mekanik novator, kryemekanik i ndërmarrjes dhe shefa të mekanikës: Xh. Karaj, P. Papakroni, teknikët: A. Belliu, M. Thomai, Sh. Dërka, E. Nezha. Sondistët: L. Hasani, T. Bushi, A. Veliu, L. Kacabuni. Drejtuesit e puseve: P. Nushi, I. Belliu, J. Ndini, punonjësit dhe e mekanikët e talentuar: Avni Balla, N. Hasalla, Jani Cakalli. Elektricitistët: T. Ndoni, G. Pepa, N. Muço etj. etj., që në pamundësi për t'i përmendur të gjithë u kërkoj ndjesë.

Dhe pusi i dytë u shpua vetëm me një konduktor të gjatë 300 ml, qe një thjeshtëzim i dytë prej 600 ml, më pak nga pusi i parë dhe, siç u tha më lart, po harrohej tashmë ajo ulja e kolonave teknike në puset e shpimit si më parë me ato gjatësi, 1500, 2000 apo 2500 ml, kur ajo lloj gjatësie e kolonave të rrethimit qe shkurtuar në mënyrë drastike në 300 ml.

PJESA E DYTË

Kthesa e papritur

Fill pas asaj pune aq të mirë në detyrën e vështirë të përgjegjësit të pusit më njoftuan që ta dorëzoja atë kolektiv punonjësish. Pa folur shumë gjatë, duhet të filloja punë në komitetin e partisë të rrethit të Lushnjës në detyrën e instruktorit të partisë, i propozuar aso kohe nga partia për t'u bërë hero i punës socialiste, po edhe kolektivin e punës tonë e kishin dekoruar për punë të mirë me medalje dhe urdhra të ndryshëm.

Siç u tha më lart, sapo e mbarova lejen e zakonshme të atij viti fill u gjenda në degën e kuadrit të komitetit të Partisë të rrethit Lushnjë dhe, pas pak çastesh në zyrën e sekretarit të parë të rrethit, sipas njoftimit që kisha marrë. Te sekretari më çoi ish-shefi i kuadrit i komitetit, J. Alija.

Sekretari nuk bisedoi gjatë me mua, ai vetëm sa e dëgjoi mendimin tim, nëse unë isha dakord apo jo që të punoja në atë komitet me detyrën e instruktorit të partisë.

Qe thjesht një takim njohje, më tepër kortezie, i sekretarit të parë me mua. Mirëpo, pa i ardhur shumë rrotull problemit për t'u shpjeguar se si dhe pse, shpejt rashë në përballjet negative dhe të pashmangshme, vetëm me njërin nga sekretarët e atij komiteti që unë isha direkt vartësi i tij, i cili në sytë të njerëzve dukej se qe vërtet engjëllor.

Por në heshtje dhe prapa krahëve ai bënte ligjin e punëve jo të mira, me tarafin rreth vetes. Pikërisht atëherë duhet t'i masje mirë qëndrimet e tua kur ti doje të punoje drejt dhe ashtu si duhej, çuditërisht mospëlqimet për punën tënde, ata nuk t'i thoshin troç e në sy që ti të vetëkorrigjoheshe.

Dhe, ç'që më e keqja, puna e padinjitetshme e tyre mbrohej nga një shoqëri e sëmurë, e cila buronte më shumë nga inferioriteti dhe dëshira për t'i mbajtur me çdo kusht vendet e punës me shoqëri e miqësi të sëmurë, ndaj dhe heshtej thuajse nga të gjithë punonjësit në atë komitet partie, dhe rrinin si të përgjunjur para bëmave të prapëta të atyre sekretarëve.

Sigurisht partiakë të atillë “të mëdhenj” fshiheshin paq nën hijen e forcës madhore të asaj partie, që ua jepte atë post, nuk kontrolloheshin fare, ose i mbulonin me marifete të gjithfarëllojshme problemet jetësore të mahisura keq. Dhe kësisoj sulmohej punonjësi që përpiquej të punonte drejt dhe me ndershmëri si duhej punuar në të vërtetë; ai që i nxirrte në dritë të diellit problemet jetësore me kurajë e shpresë zgjidhjeje

edhe pse e dinte që gjithçka po kalonte në kolaps të rrezikshëm. Në të njëjtën mënyrë sulmoheshin pa frikë fare nga ata lloj partiakësh sekretarësh dhe strukturat e shtetit

Vetëm sekretari i parë Iliaz Reka ishte njeriu model i punës dhe i sjelljes, në atë komitet partie. Fatkeqësisht ai njeri aq i mirë vdiq në zyrën e tij të punës ende pa i mbushur gjashtë muaj në atë komitet.

Qe një vdekje e trishtë dhe tejet e dyshimtë për nga rrethanat se si ndodhi ajo. Sekretari pësoi atak kardiak në karrigen e tij të punës, rreth orës nëntë të paradites. Thoshin se shumë partiakë dhe njerëz që nuk e donin atë sekretar e festuan vdekjen e tij.

Mirëpo vdekja e papritur e atij sekretari për fatin e tij të keq, mua më prishi shumë punë më pas, dhe pse u mundova aq shumë që punën ta bëja me korrektësi dhe drejtësi, por nuk kish qenë e thënë që të punohej drejt dhe mirë ashtu si duhej punuar. Qe një zhgënjim total i imi që ngelte si një plagë e pashërueshme në ndërgjegjen e vetëdijes sime, e gjithë ajo punë e keqe që po bëhej në atë komitet nën vëzhgimin e rreptë e tutelën atyre drejtuesve.

Thuaje të gjithë punonjësit e aparatit bënë një punë të atillë, siç ua kërkonte sekretari. Troç, jo për të analizuar por për të rrëfyer, si mund ta gjykoje për punë të mirë dhe të drejtë, kur dikush për arsyen e urisë të tij apo dhe të fëmijëve, apo pse një plak apo një gruaje shtatzënë i kish shkuar mendja për një kalli misri apo një kokërr domate të hershme?! Thjesht për

ato arsye njerëzore njeriu i afërt i tyre merrte pesë kallinj misri apo pesë kokrra domate në bllokun e fermës, apo të kooperativës bujqësore, në një kohë kur domatet qelbeshin në arë dhe derrave të fermës apo të kooperativës misri u ndërrohej për orë e çast me shumicë dhe sipas qejfit.

Dhe ai njeri që kish marrë ata pesë kallinj misri, apo ato kokrra domate, quhej hajdut dhe dënohej për aq gjë, hiqej nga detyra dhe, nëse ishte anëtar i partisë, përjashtohej nga partia si prishës i figurës morale të anëtarit të partisë, apo i gjendeshin yçkla të tjera që ai njeri të futej dhe në burg, nëse donin ata qehallarë partiakë e levat e tyre të bindura verbërisht.

Kjo ndodhte, kur të tjerët ashiqare merrnin si në mallin e babait, vidhnin me makina, hekur, çimento, dru për ndërtim, tulla, tjegulla, vidhnin magazina, bënë orgjira nëpër zyrat, hanin darka dhe dreka të pamerituara, madje dhe ndërtonin në mes të ditës për veten dhe për të tjerët. Dhe një dreq e dinte se çfarë bënin tjetër të tillë njerëz, dhe hajdutilleqe të tilla përfliteshin dhe përçmoheshin me zë e nën zë nga populli dhe partia në bazë.

Për çudinë e madhe prapësi të atilla faleshin me urdhër nga lart po nga ata lloj sekretarësh, që kishin edhe gurin, edhe arrën në dorë. Sapo m'u mbushën dy vjet pune në atë komitet partie, një pasdite vonë, u mblodh organizata e partisë e aparatit pa njoftim fare.

Pa humbur kohë sekretari i organizatës filloi të lexonte një lloj karakteristike sterrë të zezë për mua.

Nuk po kuptohej se ç'po ndodhte dhe se kush e kish organizuar atë mbledhje ashtu pa njoftim dhe me urgjencë.

Sekretari e mbaroi së lexuari atë biçim karakteristike. Shpejt pas tij u ngrit njëri nga sekretarët e rrethit dhe diç tha si miza në qyp pa thënë në fakt asgjë fare në drejtim të punës time.

Fjalët më të rënda të atij sekretari për mua qenë: ky djalë të jetë më i duruar, të pyesë dhe të dëgjojë më të mëdhenjtë, pse jo, dhe t'u bindet atyre se dhe më i vogël është nga të gjithë ne këtu, tha së fundi sekretari. Ndërsa kushdo do t'i kuptonte ato thënie të atij sekretari, se puna atje në atë komitet partie po bëhej e bazuar vetëm në moshën dhe respektin e ndërsjellë. Por pse unë e kisha shfaqur atë padurim dhe kë do të pyesja, dhe për çfarë, folësi i parë nuk tha asgjë nga këto.

Pas një heshtje fare të shkurtër u ngritën dhe dy instruktorë partie të tjerë që dhe ata folën në përgjithësi. Qartë dhe shkurt foli shefi kuadrit, J. Alija. Ish-shefi i kuadrit që foli qetë dhe shumë ngadalë, i drejtuar nga unë. Ai tha:

- Lëreni, more, djalin të punojë. Po të punojnë të gjithë si ky, ne kushedi se ku do të ishim tani.

Fjalët e thëna nga shefi i kuadrit qenë tërësisht në adresën e sekretarëve të partisë të rrethit, të cilët ishin ulur në krye të sallës dhe prisnin me padurim që të çoheshin punonjësit e tjerë të aparatit dhe të flisnin për mua. Por vetë sekretarët nuk e thanë qoftë

dhe një fjalë të vetme, se për çfarë arsye që bërë ajo mbledhjeje turravrap e organizatës të aparatit të partisë.

Dhe në fund të fundit të argumentonin, pse që bërë ajo karakteristikë aq e zezë, më e zezë sesa vetë e zeza për mua. Mbledhja që sajuar enkas e tillë.

Dhe ashtu si u nis u mbyll pa vendim dhe konkluzion, vetëm se m'u thanë nga sekretari i organizatës që të pushoja nga tri a katër ditë dhe pastaj t'u ktheja përgjigje atyre, por se çfarë përgjigje do t'u ktheja, as Zoti nuk e dinte. Veçse për mua që shumë e qartë, atyre u duhej vetëm heshtja dhe përulja ime para prapësive të tyre të panumërta.

Të nesërmen sapo mbërrita, ashtu si një njeri që i dukej vetja jo më si punonjës i atij aparati partie, te dera e komitetit më pristë dezurni i komitetit i asaj dite. Sa iu afrova ai më foli si me axhele dhe tha:

- Shpejt se juve po ju presin lart në mbledhjen e partisë.

Kurrë nuk më kish vajtur mendja për një mbledhje të dytë partie po për mua, fill pas disa orëve gjumi.

- Uluni shpejt, - tha sekretari i organizatës R. Canka dhe filloi të lexonte një karakteristikë tjetër për mua.

Duhet thënë se karakteristikën e dytë për mua e kishin qarë, e kishin bërë vërtet si për një hero, që dhe unë vetë po ta kisha shkruar ashtu me dorën time, me siguri, nuk do më kish lënë modestia që të shkruaja ashtu. Ja dhe hileja e paramenduar doli, belbëzova me vete.

Ndërsa sekretari pyeti si me ngut dhe me një lloj krenarie që deshi të thoshte, ja dhe këtë herë të

ndihmova, por dhe ti të shkretën mos e menderos më punën, më dëgjo mua dhe ta mbyllim paq këtë djallo punë. Isha vërtet në një dilemë të madhe.

E para nuk bëhej shaka me partinë e asaj kohe, dhe sidomos kur ajo të vinte emrin në rreth dhe, e dyta që fare thjesht për ta menduar, duke u dashuruar aq shumë pas punës time, kokëfortë për të mbrojtur të vërtetën, mund të humbisja gjithçka të mirë që kisha arritur deri në atë kohë, dhe vendin e punës nga kisha ardhur aty, se titullin e heroit dhe shkollën e partisë që ma kish propozuar dikur sekretari i organizatës në një bisedë intime, i kishte marrë lumi në atë kohë.

Troç, ata më kishin lënë pakëz kohë që të mendohesha mirë para se unë të vendosja dhe të zgjidhja, ndaj dhe sekretari më kish thënë mendohu dhe njëherë, që unë të mendohesha dhe të veproja saktë si e donin ata, ndryshe bukën e tyre të mykur ma kishin hedhur te këmbët si bukën e një qeni.

Pra, më kërkohet që të zgjidhja alternativën që të doja, ose frikën dhe punën si e donin ata, ose të vërtetën, kryeneçin kokëfortë, për të bërë punë të mira, dhe për të jetuar i lirë në truallin e asaj të vërtete të madhe, siç unë kisha punuar dhe jetuar deri aso kohë.

Por dhe nëse do të këmbëngulja, me siguri, do të flakesha si një leckë e ndotur e më keq, pa e ditur fare se ku do të përfundoja në të ardhmen.

Dhe në të dyja rastet ata ishin të fituar, nëse ndryshoja rrugën unë nuk do t'ua çaja më kokën dhe

ata do të punonin të qetë siç e kishin zakon. Po dhe nëse do të ikja që aty dhe do të syrgjynosesha gjetiu, kush dreqi e dinte se ku, prapë ata do të thoshin se vetë e pati fajin, i tillë që, i dolëm borxhit por ai që kokëfortë, apo ai nuk di gjë fare për këto punët e partisë, kokën atje te hekurat e naftës e kishte, ne ia dhamë atë punë dhe ai vetë i ra të mirës me këmbë, ne e bëmë tonën, e këshilluam, por ai prapë nuk na dëgjoi. Pastaj dihej nga të gjithë se ata lloj sekretarësh nuk i çante as djalli vetë me atë monolitetin e miqësisë dhe shoqërisë së tyre të sëmurë që ishin aq të qepur me njëri-tjetrin, kur njëra nga sekretaret L. C., bënte mbledhjet me Enver Hoxhën, dhe në grupin e sekretarëve ajo kish dy dhëndurët e saj, paçka se unë shkoja mirë me ata.

Mua më lehtësonte fakti i punës time që nuk kisha shkelur në asnjë dërrasë të kalbura, bëja një jetë e punë korrekte, por ama e dija se isha ndeshur me fajet e fajtorëve të sërëve të larta, qysh në kohën kur jetonte sekretari i parë, Iljazi.

Pas tri ditësh shkova dhe mora largimin nga puna me motivacionin: “Është treguar i padurueshëm me më të mëdhenjtë”, apo diçka e tillë që të linte të kuptohej, se isha treguar kokëfortë. Largimin nga puna ma dha njëri nga sekretarët, dhëndri i “Mbretëreshës të partisë të rrethit”, jo shefi i kuadrit.

Duhet thënë se është vërtet interesante. Me shkrepjen e demokracisë dy nga ata sekretarët me

biografi gjoja aq të mirë, aq sa ishin bërë sekretarë partie rrethi, miqtë familjarë ikën refugjatë në Greqi, pastaj në Amerikë. Por e theksoj, se nuk qenë ata sekretarë gjynahqarët për sa u tregova më lart, përkundrazi me ta shkoja mirë, të paktën kështu dukeshin gjërat në aparence.

Ai P. N., që i trazonte tërë ato punë atje, kur e mendoj kështu ndonjëherë trishtohem aq shumë për bashkëshorten e tij, e cila ishte shefe e kuadrit në ndërmarrjen e shpim kërkimit, dhe që mua me kish respektuar dhe ndihmuar, para dhe pasi kisha ikur nga komiteti, mbase dhe në kundërshtim me mendimet e të shoqit.

L. N. ishte vërtet një zonjë grua që zor se i gjendej çifti asaj gruaje, aq e sjellshme dhe tepër e dashur me të gjithë. Ndërsa me ardhjen e demokracisë pati sekretarë partie në atë komitet si dhe në shumë komitete të tjera që dolën të persekutuar dhe që arritën deri atje sa paturpësisht të merrnin edhe dëshminë e persekutimit, duke u bërë gazi i botës. Ja, kush kish qenë në të vërtetë ajo parti e punës në atë kohë dhe për tërë kohën që ne idealistët patriotë besonim në të.

Por duhej ta njihje nga afër atë parti siç e njoha unë. Kështu ika nga ajo punë në komitet. Them ika sepse brenda njëzetekatërorësh u bënë dy mbledhje partie enkas për mua, duke bërë dy lloj karakteristikash krejt të ndryshme, e para të fuste në burg, ndërsa tjetra të bënte vërtet hero, ose

anëtarin e denjë të asaj partie, dhe më thanë që të mendohesha, dhe unë u mendova dhe veprova si dhe shkrova në vitin 1976.

PJESA E TRETË

Sërish në naftë, drejt halleve të mëdha

Kur u largova nga ajo punë në komitet më sorollatën gjatë nga ndërmarrja, thjesht sepse nuk donin të më çonin më në punën time ku më kishin marrë para se të shkoja në komitet. Më në fund, pas shumë përpjekjesh dhe me ndihmën e madhe, të ish-shefes të kuadrit L. Nika, për të cilën është folur më lart, më çuan në një zonë nafte, duke më dhënë dhe sondën më të fuqishme të ndërmarrjes të asaj kohe, e cila shponte më thellë nga sondat e tjera.

Por dhe atje gjatë shpimit të një pusi të thellë nafte nuk më eci. Pasi kisha punuar dy muaj në atë pus, pikërisht kur doja të sqaroja një problem për veten time me njërin nga kuzhinierët e asaj zone, mu në derën e kuzhinës u gjenda papritur në sulmin e atij njeriu sapo i thashë se kisha diçka për t'ua sqaruar me të. Siç u kuptua më vonë ai që i porositur dhe përgatitur

që ta bënte një sherr të atillë. Dhe, në mbrojtje e sipër në përleshje kuzhinieri ra pa ndjenja dhe më vonë ai mori raport për plagosje të lehtë.

Dhe ajo çështja shkoi në gjyq. Pikërisht në atë lloj gjyqi e kuptova më qartë çdo gjë në lidhje me atë sherr banal. E gjithë ngjarja kishte qenë një kurth i vërtetë për mua, e inskenuar aq bukur nga një dorë e padukshme e dirigjuar me qëllimin e vetëm për të më baltosur sadopak mua, për të më ulur moralisht si një punëtor partie që kisha qenë, dhe, me aq, çdo gjë mbyllej paq, për çdo pretendim timin në rastin e një ankese që mund të bëja nga lart në organet qendrore të partisë, për punën atje në komitet të partisë.

Gjyqi i parë më dënoi me një gjobë farë të papërfillshme, ndërkohë sërish inskenuesit e asaj ngjarje të cilët e kërkonin patjetër dënimin tim me burg, e ndoqën dhe më tej atë ngjarje, pasi gjyqi i shkallës së parë më kish dënuar për kundërvajtje me gjobë të lehtë.

Gjyqi i shkallës së dytë, pa më thirrur fare dhe pa u mbrojtur, më dënoi me katër muaj punë me riedukim nëpërmjet punës, direkt në prodhim si punëtor, të cilën e bëra kokërr më kokërr duke ngarkuar makinat në fabrikën e tullave, dhe një pjesë të dënimit e bëra si punëtor shpimi në një sondë shpimi.

Ishte shkarja e dytë e imja, nga një shkëlqim brilant në punët e mia në naftë, i dekoruar disa herë me medalje pune dhe i propozuar për t'u bërë hero i

punës socialiste, para se të shkoja në komitet, ndërsa kisha humbur ndjeshëm moralisht pas atij dënimi sapo isha larguar nga komiteti.

Dhe pse e kisha kuptuar fare mirë psenë e fajësive të mia të pafajshme, por gjithsesi më duhej që të ruaja patjetër atë çekuilibër marramendës, që po më çonte drejt një greminë kur po e kuptoja qartë se, nëse do të ecja ashtu në atë rrugë, me siguri, do të bëhesha si një qenie e mjerë e pa zot, dhe, në fund, mund të përfundoja në një burgaxhi ordiner e në mos dhe më keq.

Menjëherë pas mbarimit të atij dënimi, pa u paraqitur fare në ndërmarrje për punë, më thirrën dhe më çuan sërish përgjegjës pusi, në një pus me përgjegjësi të mëdha. Pikërisht në atë kohë e kuptova se ende vleja shumë për punët e profilit tim në naftë, i ndihmuar sërish shumë po nga L. Nika, por dhe nga fati im që i kisha shpëtuar paq atij lloj sikleti deri në atë kohë, që edhe mund të isha dënuar dhe me burg, mbase, fal dhe aftësive të mia gojore dhe profesionale.

Pa e zgjatur shumë, ai pus kish qenë shumë problematik në bishtkolonën e tij gjatë shpimit të mëparshëm, kur pusi në fjalë ishte montuar për herë të dytë në të njëjtin vend, atje ku ishte shpuar më parë 1500 ml Më pas në atë pus i kishin ndërprerë punimet për arsye teknologjike, dhe jo teknike.

Pasi shpejt u binda për atë defekt të rëndë në bishtkolonën e pusit, mbasi atje nuk mund të vazhdonin më punimet as dhe me risk, dhashë urdhër

që të ndërpriteshin punimet, natyrisht për aq sa më takonte mua në detyrën time të përgjegjës. Forma se si e dhashë informacionin në ndërmarrje, mbase që e gabuar, por që tërësisht e riparueshme nga vetë ndërmarrja, që informacioni i dhënë prej meje mos të merrte ato përmasa teje të acaruar.

Nga ai informacioni që kisha dhënë në ndërmarrje “Pusi në pastrim për demontim”, kishin ulëritur telefonat që nga drejtoria e deri në Ministri.

E gjithë ajo ngjarje ndodhi sepse pusi sapo që montuar për të dytën herë në të njëjtin vend atje ku më parë ishin shpuar 1500 ml. Për montimin e dytë të pusit në të njëjtin vend qenë bërë tërë ato takime dhe konsulta, që nga baza e deri në Ministri.

Se pusi kish qenë me rëndësi të madhe, mbasi pritej me padurim të zbulohej një zonë e re gazi, ndaj dhe që vendosur që pusi të montohej për herë të dytë në të njëjtin vend. Një gjë të atillë nuk ta falte njeri ndaj dhe më thirrën urgjentisht në ministrin e Industrisë Rëndë.

Sapo hyra në njërin nga zyrat e Ministrisë, P. P. po më priste me sy përdhe dhe tërë inat, sa dhe dorën ma dha ashtu pa më parë fare në sy. Po ashtu e kish nisur sulmin e tij ai titullar i lartë ndaj meje, fill pas pyetjes që më bëri, se pse kisha vepruar ashtu në pus, që dhe të babait po ta kisha pasur atë pus, ashtu nuk do të veproja.

- E kur, tani, e ku, në atë pus, që ne sapo e montuam për herë të dytë, në po të njëjtin vend, me të parin.

- Ai ka qenë faji i juaj! - fola ashtu në përgjithësi dhe pa leje.

- Kupton, o debil, se çfarë ke bërë, dhe e gjithë një shkencë dhe një teknikë e tërë na paska qenë, sipas teje, kaq fajtores dhe aq e paaftë, sa ta korrigjuaka ajo bytha jote, more idiot?! Nuk ma zë goja të të them sabotator, - tha ai duke i zgurdulluar sytë që u duk dhe më inatçor në ato çaste nga sa ishte më parë. - Se nuk ngeli sabotimi që ta bësh ti, mor, more... more...

- Po ju, nuk më dëgjuat se çfarë u thashë, - fola qetë dhe sërish pa leje.

- Dukesh ti, - tha ai, - se si flet pa leje. Me ato fjalët e tua unë nuk shkoj as atje, a e kupton se për ku e kam fjalën. Atje të thashë. - Qe fjala për në hale.

- Po si duket ti qenke vërtetë idiot i lindur, - foli ai si me gjysmëzëri aty nga fundi. Që në atë kohë zëri i tij u dëgjua qartë në veshin tim, se toni i tij aq agresiv i mëparshëm dhe aq i papërmbajtur i kish rënë disi frekuenca tij në ato çaste.

Por herë shprehja e fytyrës tij i ndryshonte dhe i vetëtinte aq vetëtimthi, si ca lloj vetëtimash që nuk ndalen për asnjë çast në kohë të keqe, dhe shumë herë ato vetëtimat dalin shterpa pa u shoqëruar fare me shira.

- Mjaft u shfrytë, shoku P., iu dëgjova sa më s'duhej, a nuk po e kuptoni se e tepruat shumë dhe se unë këtë lloj dëgjimi e kam bërë i vetëdijshëm se e kuptoj se në ç'gjendje jeni, aq sa unë po u dukem i çmendur, pa më pyetur fare se kush jam dhe pse më

keni thirrur, dhe po më quani një cyth tekniku, një idiot i lindur, dhe sipas jush unë duhem arrestuar?

- Keni më, mblidhni fuqitë dhe flisni, shprehuni, nxirreni inatin, të paktën ngushëllohuni më atë inatin tuaj, se punën nuk e dini fare sesi i kini në atë pus, se asaj pune ia keni vënë ferrën qysh në lindje. I nderuar, qetësohuni, - dhe vazhdova të flisja. Por siç u duk, dhe ai i vlerësoi të thënat e mia aty nga fundi dhe po u bënte atyre analizë të hollësishme.

Dhe ashtu, si njeriu i bërë pishman foli ngadalë, prerë dhe pa më parë fare në sy.

- Po të dëgjoj, - tha ai, - me siklet të madh, por do të dëgjoj.

Fjala fol, qe fjalë e fundit e tij derisa unë ia thashë të gjitha ato çfarë kisha për t'i thënë, dhe ai nuk më ndërpreu më.

- Unë po bëj konkretisht atë punë që duhet bërë në atë pus, për të cilin ju më keni thirrur, dhe po më bëni rezil. Urdhri që kam dhënë unë për ndalimin e punimeve në pus, nuk e ka dëmtuar shtetin as moralisht dhe aq më tepër ekonomikisht, por ky qëndrimi im po e zgjon shtetin nga gjumi, dhe po i thotë se ajo punë atje nuk bëhet, dhe se ai pus nuk shkon në projekt.

Në çast, habia në sytë e bashkëbiseduesit mori arratinë dhe, po në atë moment, erdhi si me axhele në vendin e asaj habie, tërë ai shqetësim i detyrës së tij.

- Tani të jepni urdhër juve ajo punë atje fillon sërish dhe pse jam këtu me juve, kaq e thjeshtë është

kjo punë që ju po e ndërlikoni dhe po e dramatizoni kaq keq. Thjesht kam dhënë një informacion në ndërmarrje për atë pus, por nuk kam luajtur asgjë nga vendi as dhe qimen e flokut. Dhe nëse është për një lloj ndalese të atillë, dhe ajo është e justifikuar. Sonda po pastrohet dhe po riparohet ndonjë gjë që duhet bërë, se dhe atë unë e kam menduar, se nuk ndalet ai pus me informacionin tim, por ai pus vetvetiu është ndalur. Gjithsesi siç ju thashë, dijet e mia dhe ndershmërinë në punë, nuk i kam ndërruar dhe nuk i ndërroj as me diplomat tuaja. Dhe atje duhej vepruar tamam ashtu siç veprova unë, dhe e di fare mirë se kam vepruar shumë mirë dhe drejt. Dhe e fundit, ai pus do të ndalet dhe pa qenë unë atje, doni apo nuk doni juve, dhe askush tjetër nuk do ta vejë pusin në punë, qoftë dhe vetë perëndia.

- Moreeee, - foli vetëm kaq ai.

- Ndaj dhe po ju korrigjoj, por ama, pa u paditur më parë, për atë lloj punë aq të keqe që keni bërë atje me atë pus, të cilin mund ta quash edhe sabotim. Por mua, drejtor, më vjen keq për njerëzit e punës kur ata vuajnë dhe pësojnë goditje të tilla moralisht, fizikisht dhe materialisht. Dhe kur vuajnë tërë jetën, dhe në këtë rast do ta pësonin ata që janë marrë me atë punë atje në atë pus, para dhe më pas se shkova unë atje, por ka nga ata njerëz fisnikë dhe të ditur që vuajnë nga ato lloj informacionesh që nuk janë dhënë, por janë mbajtur dhe mbahen të fshehura thjesht nga frika, dhe për këto lloj informacionesh,

sot ka nga ata njerëz që nuk jetojnë më, dhe juve këto gjëra, i nderuar, i dini fare mirë.

* * *

- Drejtor, unë e di fare mirë se ç'do të thotë të shposh një pus dhe të shpëtosh njerëz nga burgu për ato fajë, sepse atje po rritem dhe si duket atje do të plakem, me këto punët e naftës, të cilat i njoh me rrënjë e dhëmballë, pse jo dhe më mirë nga juve inxhinier për atë punë që bëj unë.

- Po tani? - pyeti ai, që në ato çaste ai dukej se nuk e kishte më në plan që t'i hynte më një lufte të atillë si më parë. Siç u duk logjika e tij racionale, e një njeriu të ditur, ia kish kthyer vetëdijen e një drejtuesi të mirë të aso kohe të atij rangu, që nuk u lejohej të silleshin ashtu siç u soll harbutërisht me mua, dhe veçanërisht duhet thënë se, ai ishte vërtet njeri i mirë, dhe të gjitha ato që ai i tha për mua, e dija se i bëri vetëm për punën, sepse deri në atë kohë ai nuk e dinte vërtet si ishin punët në atë pus.

- Tani do t'jua argumentoj, sepse nuk shpohet ai pus, dhe një sqarim i tillë bëhet brenda dy minutave, pse për fat në atë pus janë ndërprerë punimet nga unë.

Ndërkohë që unë po i argumentoja pamundësinë fatale që ai pus nuk mund të shpohej më tutje, ai kish ngritur telefonin dhe shpejt zuri të fliste me drejtuesin teknik të ndërmarrjes, me kryeinxhinierin e saj, A. Qallija. Se dhe vetë ndërmarrja ato ditë kish punuar

shumë keq, ose me frikë, ose me qëllim për ta lënë tërë atë përgjegjësi për pusin, vetëm tek unë, që unë të përballesha i vetëm me ato hallet e pusit tonë dhe për informacionin që kisha dhënë, qenë hile djallëzore të administratorëve të thekur.

Dhe sa për sy e faqe ndërmarrja kish dërguar një njeri të paaftë, i cili nuk e hapi gojën fare, sikur të qe vërtet memec i lindur, dhe jo një përfaqësues dinjitoz në atë takim të rëndësishëm shtetëror, në Ministrinë e Industrisë së Rëndë.

P. foli gjatë me kryeinxhinierin e ndërmarrjes, ing. A. Qallija.

- Dua që atë punë atje të ma vërtetosh ti vetë, - i tha ai atij në praninë time, - dhe e dua urgjent përgjigjen nesër në mbrëmje. Se po qe kështu si po na e thotë ky përgjegjësi, ajo punë këtë djalë do ta nxirrte pa faje fare, por kjo nuk është më e rëndësishmja. Neve do na duhet që të mendohemi më gjatë për atë punë atje dhe, nëse ka diçka që nuk shkon, ndonjëri nga ne, me siguri, do shkojë me këmbët e tij, atje, e kupton së çfarë po të them.

Fjala qe për burgun.

- Djalë, - foli ai duke më parë drejt e në sy sapo e kish mbaruar atë bisedë me kryeinxhinierin A. Qallija. Dukej tërësisht me një pamje tjetër. Duke më përcjellë fare ngrohtësisht, për të dalë nga zyra e tij, tha: - Shoku Skënder, nëse është e vërtetë ajo gjendje që ju më treguat, ju i meritoni plotësisht të drejta ato fjalë që m'i thatë mua, dhe unë që tani e kam bërë

autokritikën time dhe të kam kërkuar njëqind herë të falur, dhe të gjitha çka dëgjove nga unë i kam tërhequr. Ndryshe do të keni pasoja.

Ndërkohë i buzëqeshi “shoqëruesit” tim memec nga ndërmarrja me ironi dhe u largua që aty duke na takuar me dorë. Ika dhe po thosha me vete: “Ja se çfarë i kisha bërë kokës dhe se çfarë po pësoja me atë kokëfortësinë e këmbënguljen time deri në atë kohë.”

Në vend që të ngrihesha sa më parë nga ajo gjendje ku kisha rënë, kur sërish forcat gravitacionale më tërhiqnin drejt greminës, dhe kurrsesi nuk po e thyeja dot veten time që të bëhesha gjoja i arsyeshëm, para frikës për mos t’i thënë gjërat troç dhe ashtu siç duheshin.

Me provën e parë që kryeinxhinieri i ndërmarrjes bëri direkt në pus, ai vetë në vendin e sondistit, duke më thënë dhe mua se provën në pus do ta bënte ai vetë, i buzëqesha për çiltërsinë e atij njeriu që aq shumë më kish vlerësuar, sa në një rast avarie ai më kish cilësuar si një magjistar për punën në shpimin e puseve dhe për likuidimin e avarive me iniciativën time.

Sërish ajo punë doli tamam ashtu siç e kisha menduar dhe vendosur unë. Po në atë çast dhe vetë kryeinxhinieri u bashkua me mendimin tim, që pusi të ndalej, ose më mirë ta themi se ai pus që vetëndaluar, por duhej një këmbëngulje e tillë që të shpëtohej sa më parë nga një siklet i tillë i madh, dhe nga tërë ato shpenzimet e kota monetare, të shpëtonte dhe vetë koha me gjithë njerëzit.

Pas ca ditësh erdhi urdhri me shkrim për pezullimin e punimeve në atë pus në zonën e Kanaparit të Kavajës, Kanapari 5. Në atë shkresë thuhej se pusi likuidohej për arsye teknologjike. Po do të pyesë dikush se ç'u bë më vonë? Asgjë, si në shumë raste të tjera, kur punët e natyrave të tilla lidheshin dhe lidhen me të mëdhenjtë, përgjegjësi të tilla dhe atë kohë mund të mbulohehin me vështirësi vetëm kolegjalisht, që dikush mos të bëhej kurban i asaj pune të bërë keq.

As unë vetë nuk e bëra më problem atë punë, qoftë dhe për vetë sedrën time, se e dija fare mirë se dikush nga inxhinierët që kishin punuar në pusin e parë, nuk do t'i shpëtonte paq asaj pune, e pakta pa burg dhe duke zhdëmtuar, se një montim për së dyti të atij pusi në të njëjtin vend nuk ta falte njeri. U ndërpre në punimet për arsye teknike, që në fakt ishte direkt për fajet njerëzore.

Pas viteve tetëdhjetë të shekullit të kaluar në naftë çdo gjë sa vinte dhe plakej, ndërsa kërkesa e llogarisë rritej, bashkë me të dhe dënimet forcoheshin nga dita në ditë. Që të ishe i suksesshëm dhe të haje bukën tënde duhej që patjetër të punoje tepër i vëmendshëm, duke ecur me psikologjinë e një peshkatari të vjetër, tërhiq dhe lëshojë fildispanjën e grepit, sa peshku të nxirrej në breg. Si në tregimin “Plaku dhe deti” i Heminguejit.

Sapo kisha mbaruar një pus të thellë dhe të vështirë në zonën D, më transferuan me gjithë sondën

dhe punonjësit në një zonë naftë të vështirë, për të shpuar një pus të thellë, kur atje kërkoheshin njohuri dhe kualifikime të reja specifike. Vetë zona ishte me shumë probleme, sa erdhi një kohë dhe të gjithë pusët e shpimit në atë zonë kishin rënë në avari të rëndë, aq sa ajo zonë po ndiqej për një sabotim të mundshëm.

Ndërkohë edhe pusi ynë që deri në atë kohë kishte shkuar shumë mirë, për fajin e sondistit L. Kula, dhe më pas timin, pusi ngeli në avari të palikuidueshme. Zona po ndiqej nga koha në kohë nga një organizëm miks partiak e shtetëror i ngritur enkas për naftën, i quajtur komisariati për naftën, i kryesuar nga anëtari i byrosë politike Hekuran Isai, bashkë me Pali Miskën që lidhej direkt me naftën.

Dhe, pak kohë më parë, në atë zonë, pusi C37, kishte shpërthyer fontanë e hapur dhe ishte djegur sonda e shpimit. Për atë arsye qenë dënuar me rreth 76 vjet burgim, që nga përgjegjësi, inxhinieri, sondisti, tekniku dhe punëtorë. Vetëm inxhinieri që dënuar me 15 vjet burg, dhe me një dëm ekonomik të llogaritur në miliona lekë në atë kohë, që do zhdëmtoheshin në arkën e shtetit. Këto të dhëna janë nxjerrë nga libri me titulli, “Magnet” i shkruar nga vetë inxhinieri, i dënuar padrejtësisht në atë pus.

Ai lloj defekti, siç e thashë, nuk u vlerësua sa dhe si duhej nga unë direkt, sepse i besova aq shumë përvojës dhe fortësisë të formacioneve të gëlqerorëve,